V E N D I M
Nr.497, datë 21.10.1999

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.205, DATË 13.4.1999 "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 në listën e anekseve bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Aneksi 4 ndryshohet si vijon:

""Lista e përpunimeve ose proceseve që duhet t'i nënshtrohen mallrat për të përfituar origjinën preferenciale sipas skemës së sistemit të përgjithshëm të preferencave" sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi."

- Pas aneksit 4 shtohet aneksi 4/1 me këtë përmbajtje:

"Aneksi 4/1, i emërtuar "Lista e operacioneve të punimit apo të përpunimit që kërkohet për t'u kryer për mallrat me origjinë joshqiptare, në mënyrë që produkti i fabrikuar të fitojë origjinën shqiptare në kuadër të skemës së preferencave tarifore autonome që Bashkimi Europian ka akorduar në favor të Shqipërisë", i cili i bashkëlidhet këtij vendimi."

- Pas aneksit 5 shtohet aneksi 5/1 me këtë përmbajtje:

"Aneksi 5/1 i emërtuar "Certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1", modeli i të cilës jepet bashkëlidhur këtij vendimi".

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të nxjerrë udhëzimet e nevojshme për njohjen e personave të interesuar me rregullat, sipas të cilave mallrave të caktuara që eksportohen nga Shqipëria drejt Bashkimit Europian, do të konsiderohen se kanë origjinën shqiptare, si dhe për të përcaktuar procedurat e lëshimit të certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa që brenda 10 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të autorizojë një shtypshkronjë të specializuar për shtypjen e formularit EUR.1, sipas modelit dhe kushteve të përcaktuara në aneksin 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko